



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

KËSHILLI

P/ VENDIM

Nr. \_\_\_ datë \_\_. \_\_. 2024

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PËRDORIMI E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK- NDIHMËN EKONOMIKE DERI NE 6% PËR MUAJIN SHKURT 01-29.02.2024.**

Në bazë të Ligjit nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.597, date 04.09.2019 për “Për Përcaktimin e Procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike, përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, Këshilli i Bashkisë Gjirokastër, me propozim të kryetarit të bashkisë Gjirokastër;

**VENDOSI :**

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **Shkurt 2024, 8 (tetë), individë/ familje** me fond **25,919 lekë**.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore, (Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë), si dhe Drejtoria e Financës.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT  
MERITA IRASAJ**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

KËSHILLI

P/VENDIM

Nr. \_\_\_ date \_\_. \_\_. 2024

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË BASHKISË PËR FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE PËR MUAJIN SHKURT 01-29.02.2024.**

Në bazë të Ligjit nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike, përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, vendimit Nr 85 datë 10.02.2021, si dhe bazuar në Udhëzimi nr.4 datë 17.02.2017 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pika 7, Ligjit nr. 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Ligjit 68/2017 “Mbi Financat e Vetëqeverisjes Vendore” VKB nr. 113 datë, 14.12.2023 për “Për Miratimin Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe Buxhetit Vjetor 2024” është miratuar fond “Ndihma Ekonomike” me fond limit 1.800.000 lekë/ vit, Këshilli i Bashkisë Gjirokastër.

**VENDOSI :**

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **Shkurt 2024**, **39 individë/ familje me fond 121,573 lekë.**
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore, (Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Shoqërore), si dhe Drejtoria e Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT**  
**Merita ISARAJ**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA GJIROKASTËR**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

**P/V E N D I M**

Nr. \_\_\_\_ Datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

**PËR**

**“AUTORIZIMIN E BASHKISË GJIROKASTËR PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE  
PËR KALIMIN NË PRONËSI TË PRONËS SË PALUAJTSHME ME EMËRTIMIN  
SHTËPIA E OFICERAVE (KATI I DYTË DHE I TRETË) QË DO TË PËRDORET PËR  
USHTRIMIN E DETYRAVE TË SAJ FUNKSIONALE ”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 , shkronja “b” dhe nënpika 1.2 ; nenit 25; nenit 55 pika 2 dhe 6, Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; Ligjit Nr.8743 datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” të ndryshuar, nenit 3 pika d) të Ligjit Nr.8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, pikës 6 dhe pikës 14, paragrafi i dytë i vendimit Nr.500 , datë 14.08.2001 të Këshillit të Ministrave “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, pikës 1, shkronja “a”, të Udhëzimit Nr.15, datë 30.06.2003, të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2024 ;

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e kërkesës për kalimin në pronësi të Bashkisë Gjirokastrë të “Shtëpisë së Oficerave”, kati i dytë dhe i tretë, me vendndodhje lagjia “18 shtatori”, Zona kadastrale 8541, me numër pasurie 24/15 dhe indeks harte Gj- F7, 67, Lloji i pronës ndërtesë.
2. Ngarkohen Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve Publike, Drejtoria e Trashëgimisë, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve , Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licensave dhe Drejtoria e Urbanistikës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit të tij.

**SEKRETAR I KËSHILLIT**

**Etleva Yzo**

**KRYETAR I KËSHILLIT**

**Merita Isaraj**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**P/VENDIM**

**NR. \_\_\_\_\_ DATË, \_\_\_\_\_ : \_\_\_\_\_ :2024**

**“PËR MIRATIMIN NË PARIM TË MARRËVESHJES SË BINJAKËZIMIT  
NDËRMJET BASHKISË GJIROKASTËR DHE KOMUNËS SË BUJANOVÇIT”**

Në zbatim të ligjit nr 115/2014 “Për ndarjen administrative –territorial të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” Ligji 139/2015”Për vetëqeverisjen vendore” Vendimi nr 228 dt 23.04.2004 “Për rregullimin e veprimtarisë me jashtë të administratës shtetërore , i ndryshuar, si dhe nga komunikimi midis Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë dhe përfaqesuesëve të Bashkisë së Bujanovcit për të kaluar në një binjakëzim institucional midis bashkive, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë , Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_2024,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë në parim marrëveshjen e bunjakëzimit ndërmjet Bashkisë Gjirokastrë dhe Komunës së Bujanovcit , Serbi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas afateve të përcaktuara në nenin 55, pika 6 të ligjit Nr139/2015”Për vetëqeverisjen vendore”.

**SEKRETAR I KËSHILLIT**

**Etleva Yzo**

**KRYETAR I KËSHILLIT**

**Merita ISARAJ**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR  
KËSHILLI I BASHKISË**

**P/VENDIM**

**NR. \_\_\_\_, datë \_\_\_\_ : \_\_\_\_ :2024**

**“PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” PËR Z. ARBEN ISA BAJO( pas vdekjes)”**

Në kuadër të vlerësimit të figurës së Z. Arben Isa Bajo si dhe në zbatim të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 54, pika (m) si dhe Ligjit Nr.112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit", V.K.M Nr. 861, datë 10/12/2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimorë për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit", Këshilli i Bashkisë i mbledhur në datën \_\_\_\_\_.\_\_\_\_2024, pasi mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë,për dhënie tituli "Qytetar Nderi" për Z. Arben Isa Bajo , si dhe mbështetur në relacionin e Komisionit Vendor për Dhënien e Titujve të Nderit,

**VENDOSI:**

1.Të miratojë dhënien e titullit “Qytetar Nderi” për Z. Arben Isa Bajo (pas vdekjes) me motivacionin:

**“Për veprimtarinë shumëvjeçare krijuese në fushën e artit dhe skulpturës, duke krijuar vepra me nivel të lartë artistik, si dhe për kontributin e tij të spikatur në përgatitjen e brezave të rinj në fushën e arteve pamore”.**

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Trashëgimisë, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

3.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, neni 55 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” .

**SEKRETAR I KËSHILLIT**

**Etleva Yzo**

**KRYETAR I KËSHILLIT**

**Merita ISARAJ**